

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRATIVU

Prilq/Bshr. 188
Data/Hetor. 07. 11. 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.11.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1528, të datës 19.10.2023, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 6, nenin 7, të Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur Nr. 04/L-143, (Gazeta Zyrtare Nr. 02/2013), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

**Për aprovimin e Propozimit Nr. 1528, të datës 19.10.2023, për shfrytëzimin e mjeteve
financiare të mësimi joformal**


1. Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për Rroga dhe paga’.
2. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej 15,176.72€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Profesionale ‘Hoxhë Kadri Prishtina’, kodi i programit Nr. 94232, shuma prej: 9,421.48€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike ‘Minatori’, kodi i programit Nr. 94231, shuma prej: 5,755.24€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB,
Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 06.11.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1060, të datës 19.10.2023, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ë), 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1060, të datës 19.10.2023, për sigurimin e qëndrueshmërisë funksionale të Qendrës për Karrierë në Fushë-Kosovë


1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1060, të datës 19.10.2023, për sigurimin e qëndrueshmërisë funksionale të Qendrës së Karrierës, si pjesë përbërëse e IAAP në kuadër të Shkollës së Mesme Teknike 'Minatori' në Fushë-Kosovë.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe sigurimin e mjeteve financiare nga buxheti i komunës, për përkrahjen e funksionimit të Qendrës së Karrierës, në kuadër të Shkollës së Mesme Teknike 'Minatori' në Fushë-Kosovë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.11.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.10.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 181, të datës 20.10.2023, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues i grupit;
 - 1.2 Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.6 Arbnore Kelmendi - Përfaqësuese e Nismës Socialdemokrate, anëtare;
 - 1.7 Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.8 Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtar;
 - 1.9 Artan Asllani - Përfaqësues i Listës Ndryshe, anëtar;
 - 1.10 Qëndresa Ademi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare;
 - 1.11 Radoman Doderovic - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare;
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) e vendimit, është hartimi i Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

